

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Marin Mema rikthen Mbretëreshën Teutë në piedestalin e nderit
ADRESA	https://a2news.com/blog/marin-mema-rikthen-mbretereshen-teute-ne-piedestalin-e-nderit-i1185128
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:12:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:09:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8dcb617ac9c7498a296dab7034df76ac1102f65051d85f1def234aa7b87b15d8
TEKSTI	f112e0362d34908d29a63a1dd3f8f3bdeed2e74fb74c6907d0d6722cfa9e6b34
PAMJA	baa5a85bdf993a60b33d2d1f7d468e2539de9798572276566bd84bcb99a83fd8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	852b030ae68b8040b61b9a33ccad5c91f77d584b66531369ee732a014101eee2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bcddc39124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/852b030ae68b8040b61b9a33ccad5c91f77d584b66531369ee732a014101eee2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Marin Mema rikthen Mbretëreshën Teutë në pedestalin e nderit

Nga A2 CNN
15 Shtator 2026, 19:09 | Blog



Nga **Marin Mema**

Rikthimi i Mbretëreshës Teuta

Kur e nisa këtë projekt në vitin 2022, nuk e mendoja se rrugëtimi i tij do të ishte kaq i gjatë. Ashtu siç e nisa, me shumë dashuri, po kështu e ndoqa hap pas hapi, pa ditur se do të përballesha me një kalvar të gjatë pengesash. Prej institucioneve, nuk kërkoja asgjë, asnjë mbështetje financiare, asnjë favor!

Projektin e nisa këtu, në faqen time dhe ai u mbështet nga shqiptarët e zakonshëm! Edhe fondi për realizimin e monumentit u mbledh këtu! I gjithi këtu, pa asnjë mbështetje të pushtetit lokal apo qendror!

Ky ishte hapi i parë, që u ndoq nga shumë hapa të tjerë... nga ideja, tek konkursi, bocetet, përzgjedhja e deri tek realizimi i shtatores!

Në fund, ndaj institucioneve parashtrova vetëm një kërkesë, atë për një hapsirë pak metra katror për të vendosur shtatoren. Vetëm kaq. Pak metra katror, por... kjo zgjati thuajse 4 vjet! Vite e vite, për të marrë dakordësinë për një monument që ishte realizuar, por nuk kishte ku të vendosej. Kjo shtatore bronzi, edhe pse e përfunduar, nuk kishte një vend.

E megjithatë, ashtu siç e nisa, nuk do t'a lija pa çuar deri në fund! Pas shumë pune, lodhjeje, takimesh, kërkesash dhe diskutimesh me disa bashki në vend, ku shpesh prej tyre mora pas vetëm refuzim....në fund, ishte Bashkia Lezhë, institucioni që hapi portat për vendosjen e kësaj shtatore në territorin e saj.

Një vlerë të shtuar i jep edhe fakti që vendosja e shtatores u miratua në muajin janar të këtij viti, me votë unanime nga të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak të Lezhës, pa asnjë dallim.

Monumenti së bashku me bazamentin (pedestalin) në tërësi do të ketë një lartësi mbi 8 metra. Kjo do të jetë shtatorja e parë e këtij lloji në trojet shqiptare, por shpresoj jo e fundit. Ndihej i lumtur që e hapa këtë portë, përmes së cilës shpresoj të rikthejme mbretërit ilirë dhe figurat tona kombëtare!

E di që do të lindin pyetje se pse jo Durrësi, Shkodra apo Tirana, por nuk është koha që sqarimet të na prishin festën ??? Në shkrim, më sipër diçka e kam thënë.

Faleminderit të gjithë shqiptarëve që e mbështetën nismën time prej fillimit të saj!
Faleminderit me zemër!

TE FUNDIT

"Paragjykimet politike, të mos ndikojnë"
Kongresmeni Amerikan lëshon paralajmërimin e fortë për Hagën

SHBA merr naftën e Venezuelës?
Marrëveshja 100-vjeçare që trondit botën

Zgjedhjet dhe vonesat institucionale në Kosovë "pengojnë agjendën" me SHBA-në

🔴 "Dënimi, shkund themelet e Kosovës",
e gjithë UÇK në Hagë: Besojmë në lirinë e bashkëlufëtarëve

MË TË VIZITUARAT

Kredi dhe kritika, SHBA me plane të tjera për Shqipërinë dhe Kosovën

Vendimi historik për çlirimtarët, gjyqtarët që kanë në dorë fatin e Thaçit, V...

Karakaçi inspekton punimet për bypassin e Elbasanit: I jep zgjidhje trafikut

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Sot dua të shpreh falënderimin tim për Kryetarin e Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu, për qasjen institucionale dhe mbështetjen e dhënë ndaj këtij projekti. Gjithashtu mirënjohje të përzemërt ndaj mikut tim Paulin Zefi për kujdesin e veçantë dhe angazhimin e vazhdueshëm. Paulini këmbënguli fort që Teuta të vinte pikërisht në Lezhë. Një tjetër vlerësim i rëndësishëm shkon për miqtë e afërt, Behlul Gashi, Mevlan Mata, Albin Laci, Vilson Dautaj dhe Klodian Marku, pa mbështetjen e të cilëve konkretizimi i këtij projekti do të ishte shumë i vështirë. Janë vlerë e forcë për mua! Falënderoj padyshim skulptorin Juljan Muçollari, autorin e veprës, madhështia e së cilës do të jetë shumë shpejt e prekshme për të gjithë. Puna e Julit do të mbetet një vlerë në shekuj dhe shpresoj të pasohet nga shumë të tjerë!

Tashmë ka nisur puna për vendosjen e shtatores, me pamje nga deti, në atë që njihet si ballkoni panoramik në rrugën që lidh Shëngjinin me Velipojën, ku duket Ulqini dhe një pjesë e asaj vije të gjerë bregdetare që ajo dikur zotëronte. Nëse nuk ka surpriza, përrurimi i saj do të realizohet në 15 shtator.

Teutë, mirë se u ktheve në Iliri! Është padyshim vetëm një pjesë e hapsirës që zotëroje në lashtësi, një pjesë e Ilirisë së madhe që shtrihej edhe përtej këtij gadishulli, por rikthimi yt shpresoj ti hapë rrugën edhe kthimit të mbretërve të tjerë.

(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Më 16 shtator nuk gjykohen vetëm katër të akuzuar – edhe gjykata speciale do të jetë në bankën e provës



Ndoshta së shpejti intelijenca artificiale do ta zgjedhë presidentin e Kosovës



Ben Blushi: Pse janë kaq të shëmtuar filmat e rinj shqiptarë



“Xhesjoni nuk mbërriti dot në punë sot në mëngjes! E vranë!”



Kosova para dhe pas 16 shtatorit



Armë në mal, dron me eksploziv në aeroport, plane për atentate: Shërbimet sekrete ruse i kanë shpallur luftë Gjermanisë

Latest Videos



Serbia, Rusia dhe Kina të interesuara që komandantët e UÇK-së të dënohen, duan të dëmtojnë Kosovën



Amerika ngre zërin ndaj Hagës, Gjykata Speciale lë në paraburgim dhe dy muaj Veselin dhe Krasniqin



"U hap akademia ushtarake Hamëz Jashari", ish-koloneli tregon si funksiononte UÇK gjatë luftës



Në UÇK trajnoheshim për të drejtat e njeriut dhe ligjet e betejës, askush s'ka bërë krime lufte

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulio
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.